

URDHËR
Nr. 2368, datë 9.11.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 28, germa “d”; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e znj. Eljona Doçi, drejtor i Njesisë Juridike dhe Kontrollit, të kompetencës për të sigluar shpërndarjen e korrespondencës shkresore të administruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë njësive/drejtorive/sectorëve.

2. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Njesisë Juridike dhe Kontrollit, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës, në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “ç”, të Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës, kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

3. Ngarkohet drejtori i Njesisë Juridike dhe Kontrollit dhe sektori i Arkivit dhe i Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dallëndyshe Bici